

PROGRAMI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË RESURSEVE UJORE NË KOSOVË (IWRM-K) - FAZA 2 Maj 2024 – Prill 2029

THIRRJE PËR APLIKIM – CA-2025-002

Trajnime dhe grante për mbështetjen e fermerëve në zbatimin e praktikave agro-ekologjike të menaxhimit të plehut organik në pellgun e lumit Ibër.

24 nentor 2025



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

SKAT Partners for Impact

ENVIRONMENT AGENCY AUSTRIA **umweltbundesamt**^U

The IWRM-K is a Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and Government of Kosovo Program, implemented by SKAT (Switzerland) in consortium with the Environment Agency Austria (EAA).

Sfondi dhe Qëllimi i Thirrjes

Programi i Zvicrës dhe Qeverisë së Kosovës “Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë (IWRM-K)” (në vijim “Programi” ose “IWRM-K”) ka për qëllim të forcojë kapacitetet afatgjata për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në nivel të pellgjeve lumore, në përputhje me prioritetet socio-ekonomike të Kosovës dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Në Fazën 2, Programi vazhdon të promovojë kalimin nga një qasje e fragmentuar e mëparshme drejt një modeli më gjithëpërfshirës, të integruar dhe pjesëmarrës të menaxhimit të burimeve ujore në nivel pellgu lumor, plotësisht të harmonizuar me parimet e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (IWRM) dhe me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat (EU WFD).

Duke u mbështetur në qasjet e suksesshme dhe mësimet e nxjerra gjatë Fazës 1, Programi është duke zgjeruar dhe shkallëzuar aktivitetet e tij që adresojnë presionet bujqësore mbi trupat ujqorë. Këto aktivitete vazhdojnë të promovojnë dhe demonstrojnë prototipe praktike agro-ekologjike dhe masa në nivel ferme, të cilat synojnë zvogëlimin e ndotjes nga veprimtaritë blegtorale në zonat e synuara në Kosovë.

Si pjesë e Skemës së Granteve Konkurruese (CGS) në Fazën 2, Programi fton tani fermerët (blegtorët) të interesuar, të cilët gjenden brenda zonës së Pellgut të Ibërit (shih listën e bashkangjitur të komunave që kanë të drejtë për përkrahje), të aplikojnë për pjesëmarrje në një program të strukturuar trajnimi, i cili pasohet me një skemë grantesh konkurruese. Qëllimi i kësaj Thirrjeje është të zgjerojë më tej përdorimin e praktikave mjedisore miqësore për menaxhimin e plehut organik, duke u mbështetur në rezultatet pozitive, angazhimin e fermerëve dhe modelet e dëshmuara të zhvilluara gjatë Fazës 1.

Trajnimet do të mbahen në fermën “Eurolona” në Fushë Kosovë. Transporti deri te vendi i trajnimit është përgjegjësi e vetë fermerëve të përzgjedhur, pavarësisht nga komuna prej nga vijnë.

Përmes kësaj Thirrjeje, Programi synon të përzgjedhë **50–60 fermerë që menaxhojnë ferma blegtorale** që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë, ku përzgjedhja do të bëhet **bazuar në kriteret të parapërcaktuara**. Kandidatët e përzgjedhur do të bëhen partnerë të projektit në zbatimin e praktikave moderne bujqësore, të cilat synojnë zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis dhe përmirësimin e menaxhimit të plehut organik në fermat e tyre. **Pas trajnimit do të organizohet një test me shkrim** për të vlerësuar njohuritë e nevojshme për zbatimin e praktikave të rekomanduara bujqësore, dhe bazuar në rezultatet e testit, si dhe në përputhje me kriteret e tjera të parapërcaktuara, **gjithsej 35–40 fermerë** nga të gjitha komunat e pranueshme **do të përzgjidhen si përfitues të granteve** të Programit.

Programi inkurajon fermerët blegtoralë që **nuk kanë objekte për ruajtjen e plehut**, si dhe ata që **i kanë, por janë jofunksionale**, të aplikojnë në këtë thirrje.

Komponentët e grantit

Granti do të ndahet si në vijim:

- **Pajisjet përcjellëse në fermë** (mekanizëm për menaxhimin e plehut organik, si mikser për deponi të plehut (gropë septike), rimorkio për shpërndarjen e plehut të ngurtë dhe cisternë për shpërndarjen e plehut të lëngët, dhe skreper për largimin e plehut organik nga shtalla); ose
- **Ndërtimi i plehërishteve** (varësisht nga tipi dhe kapaciteti i shtallës);

Secili nga përfituesit e përzgjedhur të granteve do të monitorohet në **tre vitet** e ardhshme dhe do të jetë i obliguar të zbatojë teknikat e sugjeruara të menaxhimit të plehut të shtallës. Gjatë kësaj kohe, ekspertët e jashtëm do të jetë në dispozicion të fermerëve për trajnime praktike dhe mbështetje specifike sipas kërkesës.

Propozimi për llojin e pajisjeve dhe materialeve që do të financohen nga Programi do të bëhet nga një ekip ekspertësh. **Prokurimi i pajisjeve dhe materialit të nevojshëm do të kryhet nga Programi (nuk parashikohen transferime në para të gatshme për fermerët e përzgjedhur).**

Trajnimet do të organizohen në muajin **Dhjetor 2025**, ndërsa testimi do të organizohet pas përfundimit të trajnimit. Materialet e nevojshme për t'u përgatitur për testim do të jenë në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve në trajnim.

Kriteret e pranueshmërisë dhe përzgjedhjes

1. Aplikacioni i kompletuar;
2. Kandidati/ja duhet të jetë 18 - 60 vjeç;
3. **Lokacioni i fermës** blegtorale brenda **pellgut të lumit Ibër**. Shih më poshtë listën e komunave të pranueshme;
4. Kandidati duhet të jetë një fermer individual me numrin e tij të regjistrimit të fermës (NIF), ose regjistrim biznesi;
5. Numri minimal i krerëve në fermë:
 - së paku 5 lopë qumështore, ose
 - së paku 10 viça (mbi 6 muaj), ose
 - fermat e përziera së paku 10 krerë lopë dhe viça

Në rast të një numri të madh aplikimesh, për qëllime të renditjes do të zbatohen kriteret shpesh mjedisore (p.sh. struktura e fermës, afërsia me trupat ujorë me status të rrezikuar, si lumenjtë Sitnicë, Drenicë dhe Llap, afërsia me zonat e mbrojtura, sistemi i prodhimit në shtallë, burimi i ujit të pijshëm dhe faktorë tjerë përkatës).

Në rast të pikëve të njëjta në renditje, përparësi do t'i jepet aplikacioneve të dorëzuara më heret dhe fermave që gjenden më afër trupave ujorë të lartpërmendur.

Procesi i Aplikimit

Formulari i aplikimit mund të plotësohet në formë elektronike duke klikuar në linkun [KËTU](#).
Kopjet e shtypura mund të merren edhe në:

- **Zyren e SHPQK-së:** Bulevardi Bill Clinton 112/11, Prishtinë.

Nëse aplikacioni dorëzohet në formë të shtypur, formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në dy kopje (në një të një nga gjuhët zyrtare):

- Një (1) origjinal
- Një (1) kopje

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në ose para orës 16:30 CEST më 8 dhjetor 2025.

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në formë elektronike në emailin projektikamp@gmail.com ose drejtpërdrejt (me dorë) në zyret e SHPQK-së: Boulevard Bill Clinton 112/11, Prishtinë.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni:
Adresa e emailit: projektikamp@gmail.com
Telefoni: +383 (0) 44 191 200

Shtojcat

1. Formulari i Aplikimit

Lista e komunave të pranueshme

Prishtinë
Podujevë
Obiliç
Fushë Kosovë
Vushtrri
Glllogoc
Graçanicë
Lipjan
Shtime
Skenderaj
Mitrovicë
North Mitrovica
Zveçan
Zubin Potok
Leposaviç

Zbatimi

Aktiviteti i përkrahur nga IWRM-K “Përmirësimi i Praktikave Miqësore me Mjedisin për Menaxhimin e Plehut Organik në Fermat Blegtorale në Kosovë” zbatohet në partneritet me Shoqatën e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK).